192. Fondi 132, viti 1982, dosje nr. 15 "Raport mbi llogaridhëniet e kuadrove të Drejtorisë së Sigurimit të Naftës për periudhën janar-shkurt 1982", me 15 faqe;
193. Fondi 132, viti 1982, dosje nr. 16 "Informacion dërguar Degës së Organizimit- Kompletimit mbi gjendjen organike, ngjarjet e ndodhura, masat disiplinore dhe stimujt moralë për 6-mujorin e I, II, të vitit 1982", me 9 faqe;
194. Fondi 132, viti 1982, dosje nr. 17 "Informacion dërguar Degës së Organizimit- Kompletimit, Drejtorisë së Policisë mbi studimet e ndryshimeve organike në sektorin e mbrojtjes kundër zjarrit", me 5 faqe;
195. Fondi 132, viti 1982, dosje nr. 18 "Raport e informacion dërguar Drejtorisë së Kuadrit mbi vazhdimin e shkollave pa shkëputje nga puna", me 11 faqe;
196. Fondi 132, viti 1982, dosje nr. 19 "Raport mbi disa projekte të punës së kuadrit, Dega e Sigurimit të Naftës për vitin 1980", me 9 faqe;

197. Fondi 132, viti 1982, dosje nr. 20 "Raport dhe informacion dërguar Drejtorisë së Kuadrit mbi planifikimin dhe realizimin e punës prodhuese", me 8 faqe;
198. Fondi 132, viti 1982, dosje nr. 21 "Informacion dërguar zyrës së kërkesë-ankesave Tiranë", me 5 faqe;
199. Fondi 132, viti 1982, dosje nr. 22 "Informacion dërguar drejtorisë së I-rë mbi dërgimin e kuadrove jashtë shtetit", me 9 faqe;
200. Fondi 132, viti 1982, dosje nr. 23 "Korrespondencë ndërmjet Degës Organizative me Degën e Sigurimit të Naftës mbi ndryshmet organike", me 9 faqe.
201. Fondi 132, viti 1982, dosje nr. 24 "Plan masash agjenturalo-operative-ushtarake", me 14 faqe;
202. Fondi 132, viti 1982, dosje nr. 25 "Raport mbi organizimin e punës agjenturiale-operative në objektet ekonomike të rëndësisë së veçantë të sistemit të naftës e gazit", me 5 faqe;
203. Fondi 132, viti 1982, dosje nr. 26 "Raport mbi punën për ndjekjen e kontrollin e elementit për të ardhmen", me 7 faqe;
204. Fondi 132, viti 1982, dosje nr. 27 "Raport mbi punën e bërë për grumbullimin, vlerësimin, përpunimin dhe ezaurimin e informacionit në kohë e instancave përkatëse", me 7 faqe;
205. Fondi 132, viti 1982, dosje nr. 28 "Informacion dërguar Komitetit të Partisë së Rrethit mbi disa shkelje të disiplinës tekniko-shkencore dhe asaj shtetërore në punë", me 6 faqe;
206. Fondi 132, viti 1982, dosje nr. 29 "Informacion i dërguar drejtorisë së I-rë mbi planifikim e shpenzimit e fundit të veçantë për vitin 1992", me 8 faqe;
207. Fondi 132, viti 1982, dosje nr. 30 "Protokoll i korrespondencës së Degës së Sigurimit të Naftës për vitin 1982", me 23 faqe;
208. Fondi 132, viti 1982, dosje nr. 31 "Plani dhe raporti i punës së sektorit të Sigurimit të Degës së Sigurimit të Naftës për vitin 1982", me 26 faqe;
209. Fondi 132, viti 1982, dosje nr. 32 "Informacion dërguar drejtorisë së I-rë të Komitetit të Partisë së Rrethit mbi disa probleme, të meta, shkelje, mungesa e çrregullime ndërmjet punës së Degës së Sigurimit të Naftës", me 69 faqe;
210. Fondi 132, viti 1982, dosje nr. 33 "Pasqyra statistikore e agjunkturës dhe përpunimeve agjenturore për vitin 1982, dërguar drejtorisë së parë se degës së I-rë", me 16 faqe;
211. Fondi 132, viti 1982, dosje nr. 35 "Procesverbale mbi dorëzimin e dokumenteve me vlerë arkivale në Degën e Sigurimit të Naftës", me 11 faqe;
212. Fondi 132, viti 1982, dosje nr. 36 "Relacion dërguar Komitetit të Partisë të Rrethit mbi materialet në ngarkim të R.P. në kontroll operativ 2B", me 5 faqe;
213. Fondi 132, viti 1982, dosje nr. 37 "Informacion dërguar Komitetit të Partisë së Rrethit mbi disa persona me përbërje e qëndrim të keq politik që punojnë në vende kyçe e me përgjegjësi për sektorin e naftës në Fier", me 36 faqe;
214. Fondi 132, viti 1983, dosje nr. 6 "Raport mbi zbatimin e detyrave për forcimin e gatishmërisë ushtarake", me 7 faqe.
215. Fondi 132, viti 1983, dosje nr. 3 "Studim mbi forcën zbuluese, dokumentuese e goditëse çdo veprimi armiqësor në sektorin e naftës e të gazit", me 13 faqe;
216. Fondi 132, viti 1983, dosje nr. 4 "Plan i përbashkët agjental dhe operativ midis Degës së Sigurimit të Naftës dhe Degës se Punëve të Brendshme për zbulimin e letrave anonime", me 9 faqe;
217. Fondi 132, viti 1983, dosje nr. 5 "Raport i Kryetarit të Degës për llogaridhënien para kuadrove të degës mbi efektivitetin e ndihmën e kontrollin për rritjen e cilësisë së zbatimit të detyrave", me 8 faqe;
218. Fondi 132, viti 1983, dosje nr. 7 "Plan masash agjenturale operative ushtarake për sigurimin e udhëheqjes së Partisë e të shtetit që do të vijë në rrethin e Fierit", me 6 faqe;
219. Fondi 132, viti 1983, dosje nr. 8 "Raport dërguar Drejtorisë së Kuadrit mbi disa probleme të punës në Kuadrin e Degës së Sigurimit të Naftës1983", me 13 faqe;
220. Fondi 132, viti 1982, dosje nr. 34 "Informacion e relacione dërguar Drejtorisë së I-rë", me 14 faqe;

221. Fondi 132, viti 1982, dosje nr. 35 "Procesverbale mbi dorëzimin e dokumenteve me vlerë arkivale në Degën e Sigurimit të Naftës", me 11 faqe;
222. Fondi 132, viti 1982, dosje nr. 38 "Plan masash agenturalo-operative për zbulimin, përpunimin dhe goditjen e veprimtarisë terroriste të disa të arratisurve", me 6 faqe;
223. Fondi 132, viti 1982, dosje nr. 39 "Informacion dërguar Komitetit të Partisë së Rrethit, mbi disa deponime të të dënuarit Th. N.", me 7 faqe;
224. Fondi 132, viti 1982, dosje nr. 40 "Informacion dërguar Degës së Punëve të Brendshme mbi shpërdorimin dhe përvetësimin e pronës socialiste në sektorë të Degës së Sigurimit të Naftës", me 15 faqe;
225. Fondi 132, viti 1982, dosje nr. 41 "Plani tematik i përgatitjes profesionale special-ushtarake të Sektorit të Sigurimit për vitin 1982", me 8 faqe;
226. Fondi 132, viti 1982, dosje nr. 42 "Procesverbale mbi asgjësimin e dosjeve të bashkëpunëtorëve", me 145 faqe;
227. Fondi 132, viti 1982, dosje nr. 44 "Informacion dërguar Komitetit të Partisë së Rrethit mbi strehimin e tri familjeve në dy godina të institucioneve dhe ndërmarrjes së naftës", me 3 faqe;
228. Fondi 132, viti 1982, dosje nr. 45 "Informacion dërguar Drejtorisë së Policisë mbi gjendjen e agjenturave të impiantit", me 5 faqe;
229. Fondi 132, viti 1982, dosje nr. 46 "Raporti dhe detyrat orientuese të sektorit të policisë për vitin 1982", me 19 faqe;
230. Fondi 132, viti 1982, dosje nr. 47 "Plani i punës i sektorit ekonomik për vitin 1982", me 7 faqe;
231. Fondi 132, viti 1982, dosje nr. 49 "Relacion mbi hartimin e projektplanit", me 61 faqe;
232. Fondi 132, viti 1982, dosje nr. 50 "Fashikulli i kërkimit për zbulimin e autorit të traktit për mbajtjen armiqësore", me 66 faqe;
233. Fondi 132, viti 1982, dosje nr. 51 "Relacion dërguar degës së kontroll-financës mbi zbatimin e buxhetit dhe treguesve të tjerë financiarë, 1 janar - 30 shtator 1982", me 16 faqe;
234. Fondi 132, viti 1982, dosje nr. 52 "Relacion dërguar Drejtorisë Ekonomike mbi inventarizimin vjetor të vlerave materiale", me 4 faqe;
235. Fondi 132, viti 1982, dosje nr. 53 "Informacion mbi disa probleme të stilit dhe metodës të punëtorëve operativ në terren", me 9 faqe;
236. Fondi 132, viti 1982, dosje nr. 54 "Evidenca e shfrytëzimit të automjeteve dërguar Drejtorisë Ekonomike për 6- mujorin e I-rë të vitit 1982", me 8 faqe;
237. Fondi 132, viti 1982, dosje nr. 55 "Detyrat industriale të Degës së Sigurimit", me 16 faqe;
238. Fondi 132, viti 1982, dosje nr. 56 "Plan masash mbi forcimin e masave të sektorit MKZ", me 5 faqe;
239. Fondi 132, viti 1982, dosje nr. 57 "Informacion dërguar drejtorisë së I-rë", me 4 faqe;
240. Fondi 132, viti 1982, dosje nr. 58 "Përgjithësim mbi gjendjen morale-politike të efektivit të reparteve MKZ të Degës së Sigurimit të Naftës", me 11 faqe;
241. Fondi 132, viti 1982, dosje nr. 59. "Informacion dërguar drejtorisë së I-rë", me 6 faqe;
242. Fondi 132, viti 1982, dosje nr. 60 "Informacion dërguar drejtorisë së I -rë", me 12 faqe;
243. Fondi 132, viti 1982, dosje nr. 61 "Plane masash me rastin e zhvillimit të demonstratave", me 8 faqe;
244. Fondi 132, viti 1983, dosje nr. 43 "Raport mbi punën e bërë nga Dega e Sigurimit të Naftës për zbulimin e veprimtarisë armiqësore", me 17 faqe;
245. Fondi 132, viti 1983, dosje nr. 48 "Informacion dërguar Komitetit të Partisë së Rrethit Fier mbi të metat dhe mangësitë, problemet shqetësuese", me 45 faqe.
- 1) Pas konsultimit të dokumentacionit në bazë të pikës 1 të këtij vendimi dhe përzgjedhjes së tij nga kërkuesi, kryhet procedura e vënies në dispozicion sipas legjislacionit në fuqi.
 - 2) Kërkuesi duhet të zbatojë parashikimet e udhëzuesit "Për studiues/media, miratuar me vendim nr. 491, datë 24.09.2020 pika 8, "Çdo kërkues që synon të botojë/publikojë dokumente të siguruar nga Autoriteti është i detyruar të paraqesë studimin, artikullin, dokumentarin që e përmban dokumentacionin, pranë AIDSSH, në mënyrë që ky i fundit të mund të hetojë për shkelje të mundshme të ligjit 45/2015, apo rregullave të përcaktuara në Deklaratën e

Përgjegjësisë të nënshkruar nga të dyja palët. Pasi dorëzohet ekzemplari i studimit, Autoriteti kontrollon nëse janë zbatuar rregullat e përcaktuara dhe dokumenton rezultatin. Nëse vihet re se është shkelur ligji dhe rregullat e vendosura nga Autoriteti, rasti çohet për shqyrtim të mëtejshëm në gjykatën përkatëse”.

4. Kërkuesi zbaton në çdo rast dispozitat për mbrojtjen e të dhënave personale të ligjit nr. 45/2015 (i ndryshuar) për të dhënat personale, dhe ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” (i ndryshuar).
5. Baza ditore për konsultimin e dokumenteve është 200 faqe.
6. Ky vendim është i ankimueshëm sipas legjislacionit në fuqi.
7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetare: Dr. Gentiana Sula

Anëtarë: Dr. Albert Nikolla, Altin Hoxha, Skënder Vrioni



VENDIME

TË ORGANIZIMIT
TË BRENDSHËM
TË AUTORITETIT

Vendim nr.597, datë 05.10.2023 (i shkurtuar)

Bazuar në ligjin nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, i ndryshuar; ligjin nr. 9154/.2003 “Për arkivat”; ligjin nr. 80/2015/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; ligjin nr. 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, i ndryshuar; rregulloren e AIDSSH-së “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit”, miratuar me vendimin nr. 21, datë 09.05.2017 të Autoritetit; vendimin nr. 21, datë 09.05.2017, VKM nr. 93, datë 27.02.2019, “Për përcaktimin e tarifave dhe të pagesave për shërbimet ndaj institucioneve apo personave, që ofrohen nga Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit”, rezolutën nr.11 “Për dënimin e krimeve të kryera nga regjimi komunist në Shqipëri” (2006) dhe rezolutën “Për dënimin e krimeve të komunizmit ndaj klerit, si dhe mirënjohjen e veçantë për rolin dhe veprimtarinë e klerikëve në mbrojtje të vlerave demokratike dhe të drejtave dhe lirive themelore të njeriut” (2016), të Kuvendit të Shqipërisë, rezoluta e Parlamentit Europian mbi rëndësinë e një kujtese të përbashkët europiane (2019) dhe parimet e Rrjetit Europian të Kujtesës dhe Solidaritetit; dekretin nr.1960, date 09.11.1954 “Mbi Agjencinë Telegrafike Shqiptare”,

V E N D O S I:

1. Miratimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (AIDSSH) dhe Agjencisë Telegrafike Shqiptare (ATSH).
2. Dërgimin e kësaj Marrëveshjeje për vazhdimin e procedurave pranë Agjencisë Telegrafike Shqiptare (ATSH).
3. Ngarkohet Sekretariati Teknik për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetare: Dr. Gentiana Sula

Anëtarë: Dr. Albert Nikolla, Altin Hoxha; Skënder Vrioni;



BIBLIOGRAFIA

**E INFORMACIONIT
TË DEKLASIFIKUAR
NË AIDSSH**

Vendim nr. 13, datë 18.09.2023 (i shkurtuar)

Mbështetur në nenin 44, pika 4, të ligjit nr. 45/2015, "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë", i ndryshuar, të kreut I, nenit 22 pika 4, të ligjit nr. 10/2023, "Për informacionin e klasifikuar", i ndryshuar, në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 662, datë 15.11.2017 "Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar "sekret shtetëror"", Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar "sekret shtetëror", në AIDSSH, i ngritur me urdhrin nr. 21, datë 06.02.2023, të Kryetarit të Autoritetit "Për krijimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar "sekret shtetëror" në AIDSSH", i ndryshuar, me urdhrin nr. 56, datë 23.03.2023 "Për një ndryshim në urdhrin nr. 21, datë 06.02.2023 "Për krijimin e komisionit të deklasifikimit dhe zhvlerësimit të informacionit të klasifikuar "sekret shtetëror"", me vendimin nr. 13, datë 18.09.2023, si më poshtë:

Deklasifikoi plotësisht informacionet e mëposhtme:

1. Fondi "Të arratisur", fashikull nr. 575, me 27 (njëzet e shtatë) fletë. Dosja daton në vitet 1965-1984. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".
2. Fondi "Të arratisur", dosje kërkimi nr. 575, me 67 (gjashtëdhjetë e shtatë) fletë. Dosja daton në vitet 1958-1986. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".
3. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Tiranë, dosje përpunimi nr. 11336, "Merimanga" dhe fashikull personal për të dënuar, në total me 269 (dyqind e gjashtëdhjetë e nëntë) fletë. Dosja daton në vitet 1975-1991. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".
4. Fondi Operativ, dosje personale nr. 3785 "Kodra", me 21 (njëzet e një) fletë. Dosja daton në vitet 1956-1979. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".
5. Fondi nr. IV, dosje nr. 87, "Leksion mbi rolin e teknikës operative në zbulimin e veprimtarisë armiqësore", me 21 (njëzet e një) fletë. Dosja daton në vitin 1963. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".
6. Fondi nr. IV, dosje nr. 85, "Përgjithësime mbi një kombinacion me teknikë operative dhe mbi përdorimin e kamuflazheve gjatë veprimeve me teknikën operative", me 16 (gjashtëmbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitin 1975. Niveli i klasifikimit të dosjes është "sekret".
7. Fondi nr. IV, dosje nr. 104, "Programi i edukimit profesional të sektorit T.O. dhe K.P. për vitin 1977", me 3 (tre) fletë. Dosja daton në vitin 1977. Niveli i klasifikimit të dosjes është "sekret".
8. Fondi nr. IV, dosje nr. 125, "Analizë mbi gjendjen e instalimeve stacionare të T.O.-së", me 11 (njëmbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitin 1981. Niveli i klasifikimit të dosjes është "sekret".
9. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Tiranë, dosje përpunimi nr. 112, me 190 (njëqind e nëntëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1957-1989. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".
10. Fondi operativ, dosje formulare nr. 2868, me 41 (dyzet e një) fletë. Dosja daton në vitet 1946-1983. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".
11. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Tiranë, dosje formulare nr. 10308, me 165 (njëqind e gjashtëdhjetë e pesë) fletë. Dosja daton në vitet 1967-1991. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".
12. Fondi operativ, dosje formulare nr. 1270, me 128 (njëqind e njëzet e tetë) fletë. Dosja daton në vitet 1946-1964. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".
13. Fondi operativ, dosje formulare nr. 84, me 195 (njëqind e nëntëdhjetë e pesë) fletë. Dosja daton në vitet 1945-1947. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".
14. Fondi operativ, dosje përpunimi nr. 5323, me 164 (njëqind e gjashtëdhjetë e katër) fletë. Dosja daton në vitet 1947-1989. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".
15. Fondi operativ, dosje formulare nr. 6085, me 17 (shtatëmbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1951-1989. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".
16. Fondi operativ, dosje formulare nr. 85, me 182 (njëqind e tetëdhjetë e dy) fletë. Dosja daton në vitet 1947-1964. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".

17. Fondi dega IV, (fondi rezervë), Dosje formulare nr. 99, me 83 (tetëdhjetë e tre) fletë. Dosja daton në vitet 1975-1976. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
18. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Fier, dosje formulare nr. 100, me 60 (gjashtëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1975-1980. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
19. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Fier, dosje formulare nr. 1151, me 62 (gjashtëdhjetë e dy) fletë. Dosja daton në vitet 1971-1978. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
20. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Fier, dosje formulare nr. 101, me 48 (dyzet e tetë) fletë. Dosja daton në vitet 1962-1979. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
21. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Fier, Dosje formulare nr. 1152, me 133 (njëqind e tridhjetë e tre) fletë. Dosja daton në vitet 1974-1989. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.

KRYETARI I KDZH-së

Dr. Gentiana Sula

Vendim nr. 14, datë 28.09.2023 (i shkurtuar)

Mbështetur në nenin 44, pika 4, të ligjit nr. 45/2015, “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, i ndryshuar, të kreut I, nenit 22 pika 4, të ligjit nr. 10/2023, “Për informacionin e klasifikuar”, i ndryshuar, në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 662, datë 15.11.2017 “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”, Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “sekret shtetëror”, në AIDSSH, i ngritur me urdhrin nr. 21, datë 06. 02. 2023, të Kryetarit të Autoritetit “Për krijimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “sekret shtetëror” në AIDSSH”, i ndryshuar, me urdhrin nr. 56, datë 23.03.2023 “Për një ndryshim në urdhrin nr. 21, datë 06.02.2023 “Për krijimin e komisionit të deklasifikimit dhe zhvlerësimit të informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”, me vendimin nr. 14, datë 28.09.2023 si më poshtë:

Deklasifikoi plotësisht informacionet e mëposhtme:

1. Fondi “Instituti”, bazat teorike të shërbimit sekret të OSSH, me 4 volume në total me 585 (pesëqind e tetëdhjetë e pesë) fletë. Dosja daton në vitin 1989. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.

KRYETARI I KDZH

Dr. Gentiana Sula

Vendim nr. 15, datë 06.10.2023 (i shkurtuar)

Mbështetur në nenin 44, pika 4, të ligjit nr. 45/2015, “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, i ndryshuar, të kreut I, nenit 22 pika 4, të ligjit nr. 10/2023, “Për informacionin e klasifikuar”, i ndryshuar, në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 662, datë 15.11.2017 “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”, Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “sekret shtetëror”, në AIDSSH, i ngritur me urdhrin nr. 21, datë 06. 02. 2023, të Kryetarit të Autoritetit “Për krijimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “sekret shtetëror” në AIDSSH”, i ndryshuar me urdhrin nr. 56, datë 23.03.2023 “Për një ndryshim në urdhrin nr. 21, datë 06.02.2023 “Për krijimin e komisionit të deklasifikimit dhe zhvlerësimit të informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”, me vendimin nr. 15, datë 06.10.2023, si më poshtë:

Deklasifikoi plotësisht informacionet e mëposhtme:

1. Fondi drejtoria e dytë, fashikull nr. 2382, në ngarkim të P.K., me 141 (njëqind e dyzet e një) fletë. Dosja daton në vitet 1946-1988. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
2. Fondi Operativ, dosje agjenturale nr. 1558 “Karburantit”, me 65 (gjashtëdhjetë e pesë) fletë. Dosja daton në vitet 1977-1979. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
3. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Vlorë, Dosje përpunimi nr. 2166, në ngarkim të Sh.M., me 65 (gjashtëdhjetë e pesë) fletë. Dosja daton në vitet 1958-1987. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
4. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Skrapar, Dosje përpunimi nr. 274, në ngarkim të N.A., me 62 (gjashtëdhjetë e dy) fletë. Dosja daton në vitet 1944-1990. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
5. Fondi Operativ, dosje formulare nr. 508, në ngarkim të S.J., me 90 (nëntëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1950-1951. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
6. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Tiranë, Dosje personale dhe pune nr. 6323, “Lahuta”, në total me 71 (shtatëdhjetë e një) fletë. Dosja daton në vitet 1953-1983. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
7. Fondi dega XIII, dosje personale dhe pune nr. 22788, “Rozafati”, me 243 (dyqind e dyzet e tre) fletë. Dosja daton në vitet 1969-1989. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
8. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Durrës, dosje hetimore-gjyqësore nr. 34, në ngarkim të B.Ç., dhe E.D., me 250 (dyqind e pesëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1981-1982. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
9. Fondi Kosova, dosje nr. 312, në ngarkim të Ll.L., me 12 (dymbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1969-1989. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
10. Fondi, Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë, dosje ORV Instituti i monumenteve të kulturës nr. 2346, me 13 (trembëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1981-1984. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
11. Fondi nr. 4, drejtoria e parë e ish-Sigurimit të Shtetit, dosja nr.316 “Për L.Gj.”, me 4 (katër) fletë. Dosja daton në vitin 1989. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
12. Fondi Operativ, dosje formulare nr. 4484, në ngarkim të G.M., me 13 (trembëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1951-1985. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
13. Fondi “Të arratisur”, fashikull nr. 2319/3, në ngarkim të A.Z., me 68 (gjashtëdhjetë e tetë) fletë. Dosja daton në vitet 1945-1986. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
14. Fondi “Të arratisur”, dosje formulare nr. 846, në ngarkim të Gj.Gj., me 77 (shtatëdhjetë e shtatë) fletë. Dosja daton në vitet 1952-1976. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
15. Fondi “Të arratisur”, fashikull nr. 718/11, në ngarkim të L.Sh., me 92 (nëntëdhjetë e dy) fletë. Dosja daton në vitet 1946-1987. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
16. Fondi “Të arratisur”, dosje formulare nr. 348, në ngarkim të Z.L., me 115 (njëqind e pesëmbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1950-1987. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
17. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Korçë, dosje përpunimi nr. 436, në ngarkim të S.Ç., me 245 (dyqind e dyzet e pesë) fletë. Dosja daton në vitet 1951-1988. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
18. Fondi Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë, Dosje nr. 3, Informacione të Drejtorisë së Tretë, drejtuar Komitetit Qendror të P.P.SH-së, me 201 (dyqind e një) fletë. Dosja daton në vitet 1983. Niveli i klasifikimit “Sekret”.
19. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Përmet, dosje formulare nr. 450, në ngarkim të I.I., me 60 (gjashtëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1956-1990. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
20. Fondi të Huajt, Fashikull nr. 4031, në ngarkim të R. D., me 6 (gjashtë) fletë. Dosja daton në vitin 1982. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
21. Fondi Operativ, dosje formulare nr. 116, “Telefoni” në ngarkim të A.A., me 48 (dyzet e tetë) fletë. Dosja daton në vitet 1959-1963. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.

22. Fondi, Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë, dosje formulare nr. 9780, në ngarkim të Gj.K., me 370 (treqind e shtatëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1951-1991. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.

KRYETARI I KDZH
Dr. Gentiana Sula



KUJTESA

**DHE EDUKIMI
QYTETAR**

TË ZGJEDHUR' EKSPOZITË PËRKUJTIMORE NË 76-VJETORIN POLITIK TË DEPUTETËVE DHE INTELEKTUALËVE MË 10 TETOR 1947

Një nga historitë më të dhimbshme e tragjike, që terrorizoi mendimin opozitar dhe vrau përfundimisht shpresën për lulëzimin e vlerave demokratike/perëndimore, ekzekutimi politik i deputetëve opozitarë, në vitin 1947, nga regjimi i sapovendosur i Enver Hoxhës. u përkujtua sot në Kuvendin e Shqipërisë.



Me rastin e 76-vjetorit të kësaj ngjarje, më 12.10.2023, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, në bashkëpunim me Kuvendin e Shqipërisë, organizoi ekspozitën "TË ZGJEDHUR", me praninë e kryetares së Kuvendit, znj. Lindita Nikolla, deputetëve, familjarëve të deputetëve të dënuar, shoqatave të të përndjekurve politikë, përfaqësuesve të institucioneve, përfaqësuesve të grupeve të interesit, trupit diplomatik, aktorëve të shoqërisë civile, gazetarëve dhe të rinj.



Ekspozita përkujton "grupin e deputetëve", fillesa e një opozite demokratike, nëpërmjet tregimit të ngjarjes, kontekstit politik, dokumentacionit të kohës dhe dëshmive të familjarëve, që vijnë për publikun si një kujtim i së kaluarës tragjike të historisë sonë.

Të gjithë deputetët e dënuar ishin personalitete me kontribut të spikatur në shoqërinë shqiptare. Ata vinin nga prejardhje të ndryshme shoqërore, arsimore e politike, por bashkoheshin në aspiratën për një Shqipëri moderne, me prosperitet ekonomik e shoqëror dhe për një sistem politik liberal.

Të gjithë deputetët e dënuar ishin personalitete me kontribut të spikatur në shoqërinë shqiptare. Ata vinin nga prejardhje të ndryshme shoqërore, arsimore e politike, por bashkoheshin në aspiratën për një Shqipëri moderne, me prosperitet ekonomik e shoqëror dhe për një sistem politik liberal.



Takimi u hap me fjalën e mirëseardhjes të Kryetares së Kuvendit, znj. Lindita Nikolla e cila foli mbi vlerat evropiane të opozitarëve të parë, parlamentarizmin dhe mendimin ndryshe: *"Parlamentarizmi ishte shtylla e parë e sistemit demokratik që u godit, për t'u pasuar në vijim nga goditjet e tjera. Me këtë ekspozitë nderojmë sot kujtimin e grupit të deputetëve dhe kontributin e tyre për të ndërtuar një Shqipëri të lirë e demokratike, ëndërr dhe projekt që u ndërpre ende pa nisur mirë"*.

Dr. Gentiana Sula tha: *"Është e rëndësishme të kujtojmë ata që kundërshtuan në mënyrë aktive sundimin totalitar dhe që duhet të zënë vendin e nderit në ndërgjegjen e kombit tonë si heronj të epokës totalitare për shkak të përkushtimit, besnikërisë ndaj idealeve të lirisë, nderit dhe guximit, të cilët ata paguan me jetën e tyre."*



Prof. dr. Nevila Nika, familjare e fizikanit deputet Selaudin Tota u shpreh: *"Familjet e deputetëve të pushkatuar vuajtën pafundësisht, vuajtën moralisht dhe fizikisht, dikush bëri burg dhe internim, e dikush provoi kampet e internimit. Por, edhe ata që qëndruan në qytete vuajtën, nuk kishin të drejta studimi, të drejta për të*

punuar në një punë të denjë. Sot, ne nuk i kemi eshtrat e njerëzve tanë për t'i nderuar. I kërkojmë, ndoshta është shumë e vështirë edhe t'i gjejmë.”



Znj. Vera Karbunara, mbesë e deputetit të vrarë Sheh Ibrahim Karbunara dhe djalit të tij Hysen Karbunara: *“Dy ditë para arrestimit i thanë të largohej jashtë vendit, por ai ishte i bindur në pafajësinë e tij. Kam bërë vetëm të mira për vendin tim dhe nuk e le edhe sikur të më torturojnë mua dhe fëmijët e mi.”*- thotë ajo mes emocionesh ndërsa tregon për kalvarin e vuajtjeve që fëmijët, nipër e mbesa kaluan gjatë regjimit komunist.



Dy gjyqet e njohura së gjeri si “gjyqet e deputetëve” në shtator 1947 me në krye Shefqet Bejën dhe janar 1948 me në krye Riza Danin, shënuan politikid ndaj të zgjedhurve, dhe të zgjedhurit në këtë rast, bart dy kuptime: të zgjedhurit nga elektorati si deputetë dhe të zgjedhurit nga pushteti për t’u dënuar.

Në ekspozitë shpalosen të dhëna që tregojnë se ata u dënuan si grup, por nuk ishin grup, ata ishin opozitarë por jo pjesë e opozitës, madje ishin mandatuar deputetë si pjesë e listave të Frontit Demokratik. Ishte një nga ato gjyqe ku të akuzuarit kishin avokatë mbrojtës, por avokatët mundën vetëm të luteshin. Deklaratat e të zgjedhurve, të marra shpesh nën presion e torturë, siç do të pohojnë ata që mbijetuan, nuk do të mund të lexohen pa një sqarim të kontekstit, sepse materiali në dosje, është tërësisht i njëanshëm dhe përcjell ende baltë.



Për ndërtimin e ekspozitës janë marrë në shqyrtim dosjet hetimore gjyqësore 2224 dhe 1393 si edhe dosjet formulare të Kolë Kuqalit, Selaudin Totos, Halit Gjolenës, Isuf Hysenbegasit dhe Hasan Reçit që gjenden pranë Autoritetit të Informimit mbi Dosjet e ish-Sigurimit të Shtetit, bashkë me dosjen e grupeve Monarkiste, Social-Demokrate e të Rezistencës dënuar një vit para deputetëve e intelektualëve të marrë në shqyrtim. 76 vite pas dënimit të të zgjedhurve, disa emra janë harruar, për të tjerë nuk ka kush të dëshmojë e shpesh,

frika e persekutimit i ka fshirë kujtimet deri te trashëgimtarët. Kjo ekspozitë gjen megjithatë raste kuraje, mesazhe lirie dhe shembuj qëndrese.

Autoriteti thekson bindjen se ndërgjegjësimi i historisë është një nga parakushtet për shmangien e krimeve të ngjashme, për me tepër vlerësimi moral dhe dënimi i krimeve të kryera luan një rol të rëndësishëm në edukimin e brezave me të rinj. Përkujtime si këto duhet të mbahen gjallë për të nderuar viktimat, dënuar autorët dhe për të hedhur themelet për pajtim, bazuar në të vërtetën dhe kujtimin.

KRONOLOGJIA E NJË DEMOCIDI NGA FATMIRA NIKOLLI

Disa deputetë përfshihen në katër procese gjyqësore për dënimin e asaj që u quajt nga prokuroria e kohës organizata tradhtare “Nacional-Demokrate”: Shefqet Beja, Selaudin Toto, Enver Sazani, Sheh Ibrahim Karbunara, Irfan Majuni, Riza Dani, Faik Shehu, Islam Radovicka, Kostandin Boshnjaku, Kolë Kuqali, Arif Gjyli, Kadri Hoxha, Hysni Peja.

1942- 1943

Mestan Ujaniku, i njohur ndryshe si “legjenda e Skraparit” është themelues i njëres prej çetave të para antifashiste në Shqipëri që luftoi për çlirimin e Çorovodës më 1942. Një vit më pas, Abdyl Bani del partizan në Luftën Nacionalçlirimtare, ndërsa po në vitin 1943 Islam Radovicka caktohet komandant i zonës Vlorë-Gjirokastrë-Mallakastër.

1945

Personalitete të Frontit Demokratik, si: Riza Dani, Shefqet Beja, Kostandin Boshnjaku, Selaudin Toto, Kolë Kuqali etj. shfaqin hapur apo në biseda konceptet e tyre mbi të ardhmen e Shqipërisë, koncepte që bien ndesh me ideologjinë dhe projektet e qeverisjes që kishte regjimi që po instalohet në Shqipëri.

1 qershor 1945

Në artikullin “Beteja e ideve” në gazetën “Bashkimi”, Selaudin Toto shpalos ide liberale për zhvillimin e arsimit dhe kulturës në Shqipëri, duke besuar se debati i lirë do të çonte drejt lirisë së mendimit dhe krijimit të një shtrese të vërtetë intelektualësh në Shqipëri.

14-15 qershor 1945

Në disa artikuj të gazetës “Bashkimi”, Shefqet Beja, nënkryetari i Frontit Nacionalçlirimtar të Shqipërisë, paraqet politikat ekonomike që duhet të zbatoheshin në Shqipëri. Ai shpërfaq idetë e tij për një sistem liberal ekonomik, ku peshë dhe rëndësi duhej t’i jepej prodhuesit privat.

Gusht 1945

Mbahet Kongresi i Frontit Nacionalçlirimtar. Në Fjalorin Enciklopedik të vitit 1985 shënohet se pas Çlirimit, Kongresi i Parë i FANÇ-it, që u mbajt më 15 gusht 1945, përcaktoi detyrat e Frontit Demokratik, siç u quajt tani, në luftën për ruajtjen e lirisë e pavarësisë kombëtare, për rindërtimin e vendit, për zhvillimin ekonomiko-shoqëror e kulturor të tij në rrugën e socializmit.

President i Frontit Demokratik u shpall Enver Hoxha, Shefqet Beja nënpresident, ndërsa Toto e Kuqali, anëtarë.

9 shtator 1945

Koçi Xoxe u dërgon një udhëzim drejtuesve lokalë të PKSH-së, ku kërkon që në propozimet e tyre për t’u përfshirë në listat e zgjedhësve, të mos jenë vetëm anëtarë partie e besnikë të saj, por të përzgjidhen njerëz me ndikim dhe reputacion në zonat përkatëse.

27-29 shtator

Dy muaj përpara se të mbaheshin zgjedhjet qendrore të 2 dhjetorit 1945, u miratua një paketë ligjore për to. Ligji elektoral, Ligji mbi Asamblenë Kushtetuese si dhe Ligji mbi Listat e Votuesve kufizonin zhvillimin e zgjedhjeve të lira. Fronti Demokratik që drejtohej nga komunistët nuk lejonte krijimin e grupeve të tjera politike, ndërsa procesi i administrimit të votimit, nga komisionet të mbikëqyrësit ishte në duart e tyre.

17 tetor 1945

Në prag të zgjedhjeve për Asamblenë Kushtetuese, zhvillohet Plenumi IV i KQ-së të PKSH-së, i cili analizon situatën e brendshme dhe të jashtme të Shqipërisë. Pjesëmarrësit shprehen të shqetësuar mbi mbështetjen e masave ndaj sistemit të ri.

10 nëntor 1945

Qeveria amerikane dhe ajo britanike, përmes përfaqësuesve të tyre në Shqipëri, gjeneralëve Jacobs dhe Hodgson, i kërkojnë kryeministrit Enver Hoxha zhvillimin e zgjedhjeve parlamentare të lira, si kusht për njohjen e Qeverisë Shqiptare.

2 dhjetor 1945

Ndonëse formalisht Ligji Elektoral nuk e ndalonte kandidimin e deputetëve të pavarur, në fakt ai ishte pothuaj ishte i pamundur. Opozita kërkoi shtyrjen e, datës së zgjedhjeve, por kërkesa e tyre nuk u miratua. Zgjedhjet e para parlamentare të pasluftës mbahen me 2 dhjetor dhe kandidatët e Frontit Demokratik marrin 93.18% të votave pro. Kundër tyre votojnë 6.77%, ndërsa 0.07% e votave shkojnë për kandidatin e pavarur, Gjergj Kokoshi, ish-ministër Arsimi. Deputetë nga zgjedhje dolën edhe Shefqet Beja, Riza Dani, etj nga Fronti Demokratik. Zgjedhjet e 2 dhjetorit shënuan legjitimimin e pushtetit komunist.

22 dhjetor 1945

Kostandin Boshnjaku, drejtor i përgjithshëm i Bankës së Shqipërisë, i dërgon një promemorie Këshillit të Ministrave, ku i shpreh pakënaqësi për Reformën Agrare dhe kërkon inkurajimin e iniciativës private, *“dhe sidomos të mos e shqetësojmë herë pas here, pasi ... pa iniciativën private nuk mund të bëhet as rindërtim, as ndërtim dhe asnjë përparim në ekonominë tonë”*

10 janar-14 mars 1946

Deputetët opozitarë kundërshtojnë në komisionet e Kuvendit Popullor disa projektligje, miratimi i të cilave i hapi rrugën vendosjes së regjimit komunist në Shqipëri. Mes tyre, edhe projektligjit mbi përbërjen dhe funksionet e Presidiumit të Asamblesë Kushtetuese e Komisioneve të tij dhe sidomos të Statutit të Republikës së Shqipërisë (Kushtetuta e Republikës Popullore të Shqipërisë).

8 mars 1946

Deputeti Riza Dani debaton me anëtarin e Byrosë Politike të KQ të PKSH-së, Nako Spirun duke i kujtuar se legjitimimi i pushtetit mbështetej në dy shtylla: lufta çlirimtare dhe Fronti Nacionalçlirimtar, të cilat *“kanë pasur më tepër karakter kombëtar se sa ngjyrë ideologjike”*. Dani vëren se këtë frymë nuk e përmbante Statuti (Kushtetuta), i cili *“pa dyshim asht me frymë ideologjike si politikisht, ashtu edhe nga pikëpamja social-ekonomike. Unë për vete jam për demokraci të lirë”*.

14 mars 1946

Miratohet Statuti [Kushtetuta] i Republikës Popullore të Shqipërisë, i cili i dha fund shpresave të deputetëve për një Shqipëri demokratike.

Janar-korrik 1946

Në datat 10, 17-19, 23-27 janar 1946 arrestohen 37 veta, anëtarë të grupeve opozitare të njohura si Grupi Monarkist i Qenan Dibrës, Grupi Social-demokrat i Musine Kokalarit dhe Grupi i Rezistencës së Sami Çeribashit, me akuzat për lidhje me kriminelët e luftës, përgatitje për akte sabotazhi, agjentë anglo-amerikanë, etj. Më 2 korrik 1946 gjykata komuniste dënon me pushkatim 9 prej tyre: Talat Drini, Hivzi Golja, Tut Mëniku, Xhahit Koka, Qenan Dibra, Mehmet Beshiri, Shaban Balla, Ali Kavaja Sami Çeribashi. Ekzekutimi u bë më 3 korrik në orën 05.00 të mëngjesit.

16 gusht 1946

Arrestohet Ramë Marku.

9 shtator 1946

Bëhet kryengritja e Postribës ku sulmohen kazermat e ushtrisë dhe burgu i Shkodrës, me qëllim lirimimin e të burgosurve politikë. Ministri i Brendshëm Koçi Xoxe, më 18 shtator 1946, i deklaroi diplomatit sovjetik A.Gagarinov: *“Ne mendojmë ta shfrytëzojmë këtë rast me qëllim që të çlirohemi njëherë e mirë”*

nga çdo e papritur". Si organizator do të akuzohet edhe Riza Dani, të cilit më 9 shtator i kishte vdekur vajza e vetme në moshën 9-vjeçare.

26 shtator 1946

Arrestohet deputeti Riza Dani.

22 nëntor 1946

Arrestohet Agathakli Xhitoni.

21 dhjetor 1946

Arrestohet Abdyl Kokoshi.

23 dhjetor 1946

Kuvendi Popullor i heq Riza Danit mandatin dhe imunitetin parlamentar. Njëherësh me Danin, mandati iu hoq edhe tre deputetëve të tjerë të Shkodrës: Kolë Prelës, Zef Haxhisë dhe Hysni Pejës. Ndonëse u arrestua përpara deputetëve të tjerë, gjyqi ndaj Riza Danit u zhvillua në janar 1948.

27 dhjetor 1946

Arrestohen: Syrja Selfo, Isuf Hysenbegasi, Bexhet Shehu, Hilmi Hysi, Demir Kallarati.

7 janar 1947

Arrestohen: Salim Kokalari, Foto Bala, Hivzi Kokalari dhe Adem Beli.

12 prill 1947

Arrestohen Hasan Reçi dhe Uan (Jovan) Filipi.

17 prill 1947

Arrestohet Ramazan Tabaku.

15 maj 1947

Ministria e Punëve të Brendshme i kërkon Presidiumit të Kuvendit Popullor që të heqë imunitetet e deputetëve: Shefqet Beja, Kolë Kuqali, Selaudin Toto, Enver Sazani, Irfan Majuni, Faik Shehu, Sheh Karbunara, Kostandin Boshnjaku dhe Islam Radovicka. Heqja e imunitetit parlamentar në Kuvendin Popullor bëhet pa debat të mirëfilltë parlamentar, ndërkohë që një pjesë e tyre ishte arrestuar para heqjes së mandatit.

15 maj 1947

Arrestohen: Rustem Sharra, Avdul Bani, Nexhmi Ballka dhe deputetët Shefqet Beja, Kolë Kuqali, SelaudinToto, Enver Sazani, Faik Shehu, Ibrahim Karbunara, Kostandin Boshnjaku, Irfan Majuni dhe Islam Radovicka.

16 maj 1947

Arrestohet Halit Gjolena.

17 maj 1947

Arrestohet Mestan Ujaniku.

30 maj 1947

Deputeti Kolë Kuqali, zëvendës drejtori i Bankës së Shqipërisë dhe baba i dy djemve dëshmorë të Luftës Antifashiste vdes nga torturat, sipas studiuësve, pa arritur të nënshkruajë deklaratën e kërkuar nga hetuesit, ndonëse në dosjen e tij deklarata mban një nënshkrim. Gjithashtu, në dosje pretendohet se

ai është vetëvarur në derën e dhomës së burgut dhe është dërguar në spital ku është konstatuar vdekja e tij.

15 qershor 1947

Arrestohet Riza Alizoti dhe Paolo Saggioti.

20 qershor 1947

Arrestohen: Xhevat Xhafa, Tefik Deliallisi, Sulo Konjari, Sulo Klosi, Pertef Karagjozi, Hysen Shehu, Beqir Çela, Shefki Minarolli dhe Mehmet Prishtina.

20 korrik 1947

Arrestohet Gjovalin Vlasi.

30 gusht 1947

Aktakuza kundër deputetëve formuluar nga zëvendësprokurori Josif Pashko i fajëson se: 1. Të akuzuarit kishin krijuar një grup ilegal që në muajin shkurt të vitit 1945; 2. Kishin krijuar një Komitet Qendror kryesuar nga Shefqet Beja; 3. Kishin ndihmuar kriminelët e arratisur, me të cilët do të organizohej një kryengritje për të rrëzuar “pushtetin popullor”; 4. Kishin nxitur e organizuar Kryengritjen e Postribës të 9 shtatorit 1946; 5. Ishin të lidhur me Misionin Amerikan në Shqipëri dhe kërkonin demokraci perëndimore etj.

4 shtator 1947

Deputetët, së bashku me personat e tjerë të arrestuar si anëtarë të Organizatës Nacional-Demokratike gjykohen në dy procese të veçanta gjyqësore, që u quajtën: i pari, grupi i Shefqet Bejës dhe i dyti, grupi i Riza Danit. Gjykimi për grupin e parë filloi më 4 shtator 1947.

11 shtator 1947

Arrestohet deputeti Arif Gjyli.

10 tetor 1947

Në grupin e Shefqet Bejës gjykohen 24 vetë, nga të cilët 16 dënohen me vdekje mes tyre: Shefqet Beja, Riza Alizoti e Sulo Klosi me varje, ndërsa Irfan Majuni, Selaudin Toto, Tefik Deliallisi, Enver Sazani, Sheh Ibrahim Karbunara me pushkatim. Ekzekutimet e tyre u bënë me 10 tetor.

30 dhjetor 1947

Nis procesi gjyqësor ku gjykohen 19 vetë me në krye Riza Danin. Ata akuzohen se janë iniciatorët e një organizate klandestine kundër pushtetit popullor, janë munduar të sabotojnë reformat dhe të krijojnë disfatizëm e pasiguri, kanë krijuar lidhje me kriminelë lufte, kanë përgatitur lëvizjen e 9 Shtatorit në Shkodër, etj.

22 janar 1948

Këshilli i Gjykatës së Lartë Ushtarake, formuar prej major Niko Çetës, kapiten i parë Nexhat Hyseni, kapiten i dytë Mustafa Iljazi dhe me pjesëmarrjen e prokurorit ushtarak, kapiten 1 Nevzat Haznedari vendos dënimet si vijon:

- Riza Dani (ish-deputet), Faik Shehu (ish-deputet), Islam Radovicka (ish-deputet),
- Uan Filipi, Syrja Selfo, Hilmi Hysi dhe Hasan Reçi me vdekje.
- Kostandin Boshnjaku, Mestan Ujaniku, Demir Kallarati, Isuf Hysenbegasi, Nexhmi Ballka, Hivzi Kokalari, me privim lirie për jetë e punë të detyruar.
- Arif Gjyli (ish-deputet), Adem Beli, Ibrahim Hasanaj, Bexhet Shehu, me nga 20 vjet.
- Halit Gjolena, Kamber Backa me nga 15 vjet.

1993

Këta deputetë më 7 janar 1993, u deklaruan të pafajshëm nga Gjykata e Kasacionit me kërkesë të familjarëve të tyre, për akuzat e ngarkuara në vitin 1947, pasi një plenum me 9 anëtarë shqyrton ligshmërinë e vendimeve të komunizmit.

29 prill 2017

Enver Sazani shpallet “Qytetar Nderi i Gjirokastrës”

10 tetor 2017

Mbahet në Parlamentin e Shqipërisë aktiviteti përkujtimor “Deputetët për deputetët”

28 dhjetor 2020

Agathokli Xhitonit i akordohet urdhri “Kalorës i Urdhrit të Skënderbeut” nga Presidenti i Republikës.



**AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI
DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT**

Adresa: Njësia administrative nr. 4, Rruga e Dibrës
Garnizoni "Skënderbej", Tiranë
<http://www.autoritetidoshjeve.gov.al>